

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt.13/10/2022 me cilesine e "Ortakeve Themelues",

**FILIPPOS SAPOUNAS**, i biri i GEORGIOS , i datelindjes 09/05/1965, i lindur dhe banues ne LARISA, Greqi , madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar,identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftim AP 355209, leshuar me date 18/06/2022.

**JOSIF PIKULI**, i biri i Thomait , i datelindjes 08/05/1961, lindur ne Nivice, Sarande dhe banues ne Sarande, Lagjja nr.4 , madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes me Nr.G10508086F ,leshuar nga MB Tirane me date 27/01/2020, te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **MEKANIKA KREKEZ**

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja,Objekti

#### Neni 1

##### Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **MEKANIKA KREKEZ** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

#### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqeria **MEKANIKA KREKEZ** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **MEKANIKA KREKEZ** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohen nga ortaket themelues që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributeve te tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

**Shoqeria e ka seline ne adresen:**

**Vlore, Sarande, Lukove, Fshati Nivice, godina me Nr.Pasurie 2, Zona Kadastrale 2806.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me Vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4

**Objekti i veprimtarise**

**Riparim i mjeteve te renda, makinerive, etj.**

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Ky kapital perbehet nga kontributet:

Z. **FILIPPOS SAPOUNAS** kontribon me shumen 50,000 leke.

Z. **JOSIF PIKULI** kontribon me shumen 50,000 leke

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne 2 pjesë.

Ne baze te kontributeve te mesiperme:

Z. **FILIPPOS SAPOUNAS** merr 1 pjese te kapitalit themeltar me vlere 50.000(pesedhjete)leke.

Z. **JOSIF PIKULI** merr 1 pjese te kapitalit themeltar me vlere 50.000(pesedhjete)leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket themelues pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve themelues eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve themelues brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miratojne raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

##### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem i cili do te jete:

**JOSIF PIKULI**, i biri i Thomait , i datelindjes 08/05/1961, lindur ne Nivice, Sarande dhe banues ne Sarande, Lagjja nr.4 , madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes me Nr.G10508086F ,leshuar nga MB Tirane me date 27/01/2020,

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

#### Neni 10

##### Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të

kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ustrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve themelues merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### Neni 14

##### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqërise tregtare **MEKANIKA KREKEZ** shpk, nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmat e tyre orgjinale.

**ORTAKET E SHOQËRISE**

**FILIPPOS SAPOUNAS**



**JOSIF PIKULI**

